



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	28.02.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-65

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Prizren, më 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 178 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhje e mbajtur me datë 13.02.2020, mori këtë:

V E N D I M
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KODIT TË ETIKËS
Nr. protokolit 01 - 65 të datës 19.02.2016

Neni 1

Miratohet propozimi i Komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Etikës.

Neni 2

Neni 3 i Kodit të Etikës ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Misioni, vizioni dhe vlerat

Misioni

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, është institucion akademik e konkurrues i orientuar në ofrimin e edukimit cilësor duke zhvilluar kërkime shkencore dhe duke kontribuar në inovacion, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit ku vepron në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Vizioni

Universiteti ndërton vizionin duke u mbështetur në parimin e vlerave edukativo-kërkimore, përparësive krahasuese të diversitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor, me qëllim të krijimit të një qendre të ekselencës akademike e cila do t'i shërbej studentëve, hulumtuesve dhe shoqërisë në fushat e IT-së, agrobiznesit dhe mjedisit, menaxhmentit dhe administrimit të biznesit, drejtësisë, gjuhësisë dhe edukimit.

Vlerat

Universiteti promovon vlerat universale, grupore dhe individuale si ë vijim:

- Liria e shprehjes dhe punës akademiko-shkencore në mënyrë që të sigurohet shprehja e mendimit ndryshe;

- Ngritja e vazhdueshme e cilësisë në procesin e edukimit dhe punës kërkimoro-shkencore Konkurrentshmëria brenda Universitetit si vlerë e shtuar zhvillimit akademik dhe shkencor,
- Transparenca dhe liria e shprehja e mendimit kritik;
- Kohezioni me kërkesat e tregut të punës;
- Meritokracia si vlerë universale e njohjes së kontributeve individuale dhe grupe;
- Diversiteti lingvistik, etnik dhe kulturor si vlerë e shtuar burimore nga makromjedisi i rajonit të Prizrenit;
- Barazia sociale dhe gjinore si vlerë e fuqizimit të shtresave sociale të marginalizuara dhe fuqizimit të rolit të gruas;
- Qëndrueshmëria financiare nëpërmjet diversifikimit të burimeve për financimin e punës së Universitetit;
- Bashkëpunimi i ngushtë me komunitetin e biznesit në nivel të rajonit të Prizrenit, nacional dhe më gjerë.

Neni 3

Neni 18 pika (e) ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Zbatimi i programeve ose aktiviteteve që përbëjnë shkelje të interesave shtetërore dhe politikave të Universitetit. Studentët dhe përfaqësuesit e tyre nuk kanë të drejtë të lidhin marrëveshje të dëmshme dhe të paligjshme me palët e treta në emër të Universitetit, të cilat mund t'i shkaktojnë dëme financiare, materiale dhe që ta dëmtojnë imazhin e Universitetit.

Neni 4

Neni 26 paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Këshilli Drejtues i Universitetit do të themeloj Këshillin e Etikës i cili do të ketë 3 (tre) anëtarë nga radhët e mësimdhënësve të Universitetit, 1 (një) anëtar nga stafi administrativ i Universitetit dhe 1 (një) anëtar i zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve. Mandati i anëtarëve të zgjedhur nga stafi akademik dhe joakademik është katër (4) vite. Mandati i anëtarit nga radha e studentëve është 2 (dy) vite. Ndërsa Kryetari i këtij komisioni duhet të jetë njëri nga anëtarët e emëruar nga fusha profesionale e drejtësisë ku emërimi i tij bëhet me vendim nga Këshilli Drejtues.

Neni 5

Ky plotësim dhe ndryshim i Kodit të Etikës hyn në fuqi datën kur miratohet nga Këshilli Drejtues i Universitetit.

Prof. Asoc. Dr. ~~Bledi Mujdri~~
 Kryesues i Këshillit Drejtues



Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Njësisë Akademike;
- Zyrës së Personelit;
- Arkivit.